



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700618/4

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave dhe planifikimin e caktimit të gjykimit administrative datë 12.03.2015, të Paditësit S.S. nga qyteti i Beratit.*

Drejtuar : **ZKASTRIOT SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijëni : **ZSami STAROVA**
Lagja "30 vjetori"

BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 15.05.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi S. S. nga qyteti i Beratit, ankohet për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të një çështje dhe për shkeljen e procedurave gjyqësore, në gjykimin e një çështje gjyqësore kundra Ministrisë Financave, Dega e Thesarit dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat, me objekt detyrim për pagimin e shumës si kompensimit të burgimit të padrejtë në bazë të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Ankuesi S. S. nga ana e tij, na shkruan se me vendimin gjyqësor me Nr.501 datë 25.04.2013 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë. Kundra këtij vendimi gjyqësor janë ankuar pala e paditur dhe kjo dosje gjyqësore tani ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, nga data 12.03.2015, me Relator Gjyqtarin Z.Bari SHYTI, i cili nga ana e tij nuk ka planifikuar akoma caktimin e këtij gjykimi.

Në këto kushte dhe rrethana duke analizuar në tërësi pretendimet e shtetasit S. S., konstatohet se ankesa e tij gjendet e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe institucioni i Avokatit të Popullit, çmon se në rastin konkret ka vend për ndërhyrje me anë rekomandimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për marrjen e masave dhe planifikimin e këtij gjykimi sa më shpejtë në të ardhmen, duke patur parasysh moshën e madhe të ankuesit, faktin se ai ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore, kohën e gjatë që ka kaluar nga gjykimi në shkallë të parë si dhe kërkesat e nenit 2 të Ligjit nr.49/2012, ku ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjëvënësit në krijimin e këtyre gjykatave.

Ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, dhe se qëllimi i krijimit të gjykatave administrative ishte garantimi i

mbrojtjes efektive të të drejtave subjekteve dhe interesave vet të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Në nenin 63/4 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se:

”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike”, dhe kerkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku percaktohet se:

” Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen” dhe Ju

REKOMANDON :

1.Marrjen e masave për planifikimin e caktimit të gjyqimit të çështjes administrative të shtetasit S. S. e regjistruar për gjykim në atë Gjykatë, me datën 12.03.2015 dhe pa u gjyuar akoma.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI